33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **OB614-23-10644-5-2-1/C499**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <u>[gjuha e procedurës - shqipe]</u> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës OE, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit me afat të vlefshmërie prej 395 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt. Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre
Programi	12.1	Brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me sa vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar..
	12.2	Perioda për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik por jo më shumë se 3 ditë OE duhet të pregaditë Planin dinamik mbrenda suazave të kërkuara si në njoftimin për kontratë neni II-3 OE-duhet të duhet të deklarojë me shkrim se do t'i përmbahet planit dinamik dhe se do ta kryej projektin në afatin e paraparë.
Fillimi i punëve	17.1	Kontraktuesi do të fillojë punët brenda 5 dite nga nënshkrimi i kontratës. *Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me

		Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, Kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të palëve dhe si ditë zyrtare për fillim të punimeve do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 365 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Nëse Ofruesi i punëve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së punëve të pa kryera deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të porosisë.. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsytim dhe do të jetë përgjegjës për mos futje në penale.
Regjistri i punës	20.1	20.1 Një regjistër i punës do të, mbahet në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm: a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit; b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit. 20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij. 20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur
Inspektimi dhe testimi	22.1	Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të

		punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues. * Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord. Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Organi mbikëqyrës sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testetimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Organi mbikëqyrës nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>10% e vlerës së kontratës do jet sigurim bankar për garantimin e punimeve</i>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <i>1095</i> ditë ose 3 vite Po ashtu për sigurimin e cilësisë së punëve, Operatori Ekonomik pas pranimit teknik duhet të ofrojë garancion bankar për sigurimin e punëve 10 % nga vlera e kontratës, në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do ti sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do ti sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do ti faturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Nëse janë grup OE, kjo deklaratë epet në emër të liderit të konzorciumit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Projekt menaxheri i kontratës, personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtarin përgjegjës të prokurimit si dhe personave përgjegjës të autorizuar nga Kryersi i shërbimeve
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PROJEKTIMI I OBJEKTIT TE KOMUNITETIT | P+0

LOKACIONI: OBILIQ

INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv.

Në të gjitha pozicionet përfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PËRFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.01.01	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë për hapjen e kanaleve për themelet shiritore të objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	32.20	3.00 €	96.60 €
1.01.02	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura rreth mureve perimetrike të themeleve duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në amfijen e kompaktësisë Ms=30 MPa. Vërejtje: Për shkak të pasaktësive gjatë punës dhe mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%.	m ³	18.00	10.00 €	180.00 €
TOTAL POZICIONI				1.01	276.60 €

1.02 PUNËT E BETONIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të marr mostrat e betonit për çdo 'pari' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laborator të specializuar për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. VËREJTJE 2: Për pozicionet e parapara të betonohen me shlesa të specifikuar si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbytur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivët e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikqyrës.					
1.02.01	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve perimetrike shiritore duke përfshirë shputen dhe cokullen. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për amfijen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	12.00	85.00 €	1,020.00 €
1.02.02	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave me dimensione 25x50 cm. Shtyllat perimetrike të betonohen deri në kuotën e pilakës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	3.90	120.00 €	468.00 €
1.02.03	Furnizimi me material dhe betonimi i pilakës së perdhese (me trashësi 15 cm duke përfshirë edhe trajet). Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	22.40	110.00 €	2,464.00 €

1.02.04	Furnizimi me material, betonimi i pllakës të nënkulmit, sistemi "Fertit" mbi përdhësë me trashësi t=10 cm, me beton C-25/30 të armuar me rrethë Ø 8 çdo 20/20 cm, para betonimit konstruksioni i armaturës duhet fiksuar në pozicione të cekura në projekt. Duhet bërë mbështetjen adekuate të traut(serklazhit) si dhe sigurimin e konstruksionit nga dislokimi. Para betonimit të lagen, freskohen kallupet me ujë, të kontrollonhet stabiliteti i kallupeve si dhe rregullsia e lidhjes së konstruksionit të armaturës, të sigurohet stabiliteti me konstruksion të nënshtresës në harmoni me rregullat e përgjithshme të sigurisë, betoni të ngjeshet dhe vibrohet deri në shfaqjen e qumështit të Çimentos, pas betonimit së paku tri herë në tri ditët e ardhëshme duhet të ujitet sipërfaqja e	m ²	81.85	28.00 €	2,291.80 €
TOTAL POZICIONI		POS			6,243.80 €

1.03	PUNËT E ARMIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi me material, prejja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të anilës së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
1.03.01	Ø8,Ø10,Ø12,Rreth Q-335	kg	4,000.00	0.80 €	3,200.00 €
TOTAL POZICIONI			1.03		3,200.00 €

1.04	PUNËT E MURATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
1.04.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 20cm dhe 25cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giler G5 të lidhura me lloq të flluar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "ShamMall" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani në shtresat	m ³	41.50	50.00 €	2,075.00 €
TOTAL POZICIONI			1.04		2,075.00 €

1.05	PUNËT E SUVATIMIT & NGJYROSJES				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.05.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i sipërfaqeve të mbyllura me blloqe argjile, mureve deri në nivelin e plafonit duke përfshirë dhe plafonin e objektit me material të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çimento+agregat) ose material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me lloq sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listelat metalike për caktimin e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listelat dilatuese (anputzlesile) nga plastika me rrethë amimi dhe shirit vetngjithës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zhdruktuarisë me folie të PVC-së si dhe rrethja e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m ²	308.00	5.50 €	1,694.00 €
1.05.02	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa glet-masë RÖFIX 225 ose material të ngjashëm të përcaktuara me projekt.	m ²	269.00	4.00 €	1,076.00 €
1.05.03	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e plafoneve dhe mureve të patinuara si dhe atyre të realizuara me pllaka gjips-kartoni me ngjyrë me bazë poliuretani e cila duhet të ketë aftësi të madhe të pastërimit. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyerje bazë/primer për enterier të përshtatshme për mure dhe pllaka gjipskartoni për reduktimin e shkallës së apsorimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	269.00	2.00 €	538.00 €
TOTAL POZICIONI			1.05		3,308.00 €

1.06	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA

1.06.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në tere kthinat e brendshme , e cila do te punohet nga pllakat qeramike duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia adekuatë e aluminit me veli të reflektimit të nxehtësisë për ngrohje në dyshe me, shtresat termoizoluese dhe zëbzoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrih t=4 cm • Folie/nënshtrësë alumini për ngrohje gypore në dyshe me • Termoizolim Austrotherm EPS® A100 t=3 cm • Termoizolim Austrotherm EPS® T450 t= 2 cm	m ²	81.80	10.00 €	818.00 €
TOTAL POZICIONI		1.06			818.00 €

1.07	PUNËT E QERAMIKËS PORCELANIT GRANITIT KUARCIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.07.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë tek te gjitha kthinat e brendshme te objektit me pllaka të paglazura qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksture/dizajn të përcaktuar nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfutuesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuencim të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	79.00	14.00 €	1,106.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve deri në lartësinë e plafonit tek nyjet sanitare dhe hapësirat për pastrimin dhe ruajtjen e kufomave në përdheshë me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksture/dizajn të përcaktuara nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfutuesit e objektit. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngjicave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjytja e pllakave të bëhet me ngjytës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	40.00	14.00 €	560.00 €
1.07.03	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare në përdheshë dhe i hapësirës së depoiztave të ujit në nënkulm duke përfshirë hidroizolimimin e dyshemesë në këto kthina si dhe hidroizolimimin e mureve me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex të aplikuar në dy shtresa me trashësi nga 1 mm. Në pjesën e dusheve te nyjet sanitare hidroizolimi të bëhet deri në 2 m lartësi. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëthurave të poliesterit ose njetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasatjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	85.00	3.00 €	255.00 €
TOTAL POZICIONI		1.07			1,921.00 €

1.08	PUNËT E ZDRUKTHTARISË DYERT, DRITARET DHE ELEMENTET TJERA				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi transporti dhe montimi i Dritare PVC 80-85mm, me ngjyre te hirtë me hapje dhe kiperim, 6 dhoma te qirimit. Xham te dyfishte (termopan-double glazing) trashesi totale 6+16+4 mm. Punimi i dritareve duhet të bëhet sipas skemës dhe pershkrimit. Prodhuesi (KBE, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjetër me karakter të ngjajshëm).*				

1.08.01	POS DO-01 - Derë njëkrahëshe me mbidritë Dimensionet: 150x250 cm. <u>Dizaini sipas skemës së zdrukthtarisë</u>	copë	2	220.00	440.00 €
1.08.02	POS W-01 - Dritare PVC Dimensionet: 160x160 cm. <u>Dizaini sipas skemës së zdrukthtarisë</u>	copë	4	220.00	880.00 €
1.08.03	POS W-02 - Dritare PVC Dimensionet: 80x80 cm. <u>Dizaini sipas skemës së zdrukthtarisë</u>	copë	2	100.00	200.00 €
	POS D2 Derë e brendshme njëkrahëshe, Dimensionet: 80x210 cm. <u>Dukja si në skemën e zdrukthtarisë</u>	copë	4	160.00 €	640.00 €
1.08.04	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdimë). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm Gjerësia 23 cm (së paku 2 cm duhet të dalin jashtë murit) Ngjyra e bardhë	m ^l	8.50	20.00 €	170.00 €
TOTAL POZICIONI				1.08	2,330.00 €

1.09	PUNËT E FASADËS				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
1.09.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës termoizoluese të tipit StoTherm Vario nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër i ngjashëm i prodhuesve tjerë. Sistemi StoTherm Vario duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Ngjitës StoLevell Uni • Termoizolim Austrotherm EPS AF - t=10cm • Rrjetë Armimi Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoLevell Uni • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Uaç struktural organik StoSpolil Kratz K 2.0 mm • Ngjyrë akrilike Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, listelat dilatuese (anputzleiste) për dritare dhe dyer, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, mbajtësit konzollë për dritare dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	148.5	17.00 €	2,524.50 €
1.09.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës dekorative nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Coklla termoizoluese duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë StoPrep Contact • Ngjitës - masë hidroizoluese StoFlexyl • Termoizolim Austrotherm XPS 30 t=8 cm • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoFlexyl • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Uaç dekorativ shumëngjyrësh StoSuperlit K 2.0 mm Coklla duhet të realizohet nga kuota ±0.00 deri në kuotën -0.50 ose rreth 15 cm thellësi nën nivelin e trotuarit të përfunduar për të shmangur ekspozimin nga ujëti e mundshme të trotuarit. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibile për fugat e diletimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	22.5	10.00 €	225.00 €

1.09.03	Furnizimi dhe montimi i pikoreve nga alumini me trashësi 2 mm për të gjitha dritaret e jashtme në fasadë. Gjerësia e pikores duhet të jetë së paku 28 me kusht që pikorja të jetë së paku 3 cm jashtë fasadës. Materiali: Alumin i plastifikuar Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt Në çmim të përfshihet edhe goma izoluese vetngjyeshme EPDM për mbyllje të fugës mes pikores dhe profilil të dritares, kapakëft skajor, mbajtësit konzollë në distancë jo më të madhe se 50 cm dhe të gjitha mjetet tjera të nevojshme për fiksimin e pikoreve.	m ¹	8.5	27.00 €	229.50 €
TOTAL POZICIONI				1.09	2,979.00 €

1.10 PUNËT E KULMIT TË PJERRËT DHE LLAMARINËS					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
	Furnizimi dhe punimi i konstruksionit bartës dhe mbulesës së kulmit duke përfshirë, mbajtësit kryesor me dy breza të lartësive të ndryshme, brinjët (mohitë), dyshtemenë e punuar nga panelet OSB, membrana difuzive, mbulesa nga llamarina e trashët me lidhje vetëkuese falco, kapakët e kulmarëve, kapakët e lugjeve dhe gërmuqeve, ulluqet vertikale dhe horizontale, pikoret e mureve. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si llamarina të perforuara, pllaka dhe këndare metalike për lidhjen e trarëve, bulonat ankerues për fiksion në pllakë, gozhda, vida dhe mjetet tjera të nevojshme. Vërejtje: Sipërfaqet e folieve dhe PVC membranës janë dhënë si sipërfaqe NETO pa përfshirë pjesën e nevojshme për ngjitje mbi njëra tjetrën. Në çmim përfshihet realizimi i të gjitha shtresave të paraqitura në vijim si totale të përgjithshme për këto pjesë:				
1.14.01	KONSTRUKSIONI I KULMIT BRINJËT, NËNKONSTRUKSIONI Trarë druri me dimensione të plota 10x12 cm për konstruksionin bartës të punuar si mbajtës me trarë horizontal në dy nivele dhe vertikale në distancë aksiale 70 cm. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate. Fiksion në pllakën e betonit me anker bulona në çdo 140 cm.	m ³	5.50	200.00 €	1,100.00 €
1.14.02	PANELE OSB 3 t=18 mm Panele me trashësi 18 mm për formimin e dyshtemesë së drurit mbi trarëzat/brinjët e kulmit. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksion në trarët/brinjët e drurit - vidat/gozhdat në distancë adekuate dhe mjetet tjera të nevojshme sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit.	m ²	150.00	8.00 €	1,200.00 €
